



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1528/13 prot.

Datë 25.06.2026

V E N D I M
Nr.871/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 819/2026, datë 17.06.2026, për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur,” me REF-81377-04-08-2026, me objekt: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.” me fond limit 53,867,793.17 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Ankimues:

Operatori ekonomik “RSM COMPANY” SHPK, përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “R|S|M Construction”, me NIPT L04803001U dhe adresë Njesia Nr.8, Rruga Xhorxhi Martini, Nr. 20, Godine Nr. 11 - kateshe, Shkalla 2, Kati 7, Tiranë
Operatori ekonomik “MANE/S” SHPK, me NIPT J64103865K dhe adresë Lagja 2, P 46,, Sarandë.

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.10”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit

Publik”, Neni 4, i Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 17.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.819/2026 ku vendosi:

1. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “RSM COMPANY” SHPK, përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “R|S|M Construction” në procedurën e prokurimit “E hapur,” me REF-81377-04-08-2026, me objekt: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.” me fond limit 53,867,793.17 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.*
2. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mane/S” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga nga operatori ekonomik “RSM COMPANY” SHPK, përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “R|S|M Construction”.*
6. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mane/S” SHPK.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1888/4 prot., datë 22.06.2026 protokolluar me tonën nr. 1528/10 prot., datë 25.06.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.819/2026 datë 17.06.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur,” me REF-81377-04-08-2026, me objekt: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.” me fond limit 53,867,793.17 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 1888/4 prot., datë 22.06.2026 protokolluar me tonën nr. 1528/10 prot., datë 25.06.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.819/2026 datë 17.06.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur,” me REF-81377-04-08-2026, me objekt: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.”, me fond limit 53,867,793.17 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.819/2026 datë 17.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.819/2026 datë 17.06.2026 të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur,” me REF-81377-04-08-2026, me objekt: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë.”, me fond limit 53,867,793.17 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

